

VENDIM
Nr. 765, datë 19.12.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 215, DATË 31.3.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE,
NË BASHKITË LEZHË DHE KURBIN, DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI
ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 215, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/2 shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

“2/3. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, në masën 104 050 661,58 (njëqind e katër milionë e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.”;

b) Në pikën 3, togfjalëshi “... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2, 2/1, 2/2 dhe 2/3 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama